



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

MARRËVESHJE BASHKËFINANCIMI

**MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

DHE

**NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR STUDIMIN E FIZIBILITETIT DHE PROJEKT – IDESË
PËR LIDHJEN HEKURUDHORE DURRËS-PRISHTINË**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë, këtu e më poshtë të referuara si “palët”,

Në vijim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi bashkëpunimin në fushën e Transportit Hekurudhor,

Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës për Ndertimin e lidhjes hekurudhore Durrës – Prishtinë, si dhe

Në frymën e marrëdhënieve miqësore që ekzistojnë mes dy vendeve, dhe me qëllim realizimin e lidhjes hekurudhore Shqipëri - Kosovë, palët bien dakord dhe lidhin këtë marrëveshje bashkëfinancimi, për sa më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëfinancimi është përcaktimi i procedurave dhe ndarja e kostove ndërmjet palëve për financimin e Studimit të Fizibilitetit dhe Projekt – Idesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë.

Neni 2 Kosto totale e Financimit

Kosto totale për realizimin e Studimit të Fizibilitetit dhe hartimit të Projekt – Idesë për ndërtimin e lidhjes hekurudhore Shqipëri – Kosovë, parashikohet të jetë rreth 1,980,000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) Euro.

Neni 3 Angazhimi Financiar i secilës palë

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë do të angazhojë një fond prej 1,000,000 (një milion) Euro, ose rreth 51% të kostos totale për realizimin e këtij Projekti madhor për të dy vendet. Ky fond është parashikuar në buxhetin e vitit 2022 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës do të angazhojë një fond prej 980,000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) Euro, ose 49% të kostos totale për realizimin e këtij Projekti madhor për të dy vendet. Ky fond është parashikuar në buxhetin e

vitit 2022 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe me autorizim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 4

Detyrimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

1. Proceduarat e prokurimit për përzgjedhjen e operatorit për kryerjen e Studimit të Fizibilitetit dhe Projekt – Idesë, do të bëhen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit të prokurimit, të shtetit shqiptar.
2. Afati për kryerjen e Studimit të Fizibilitetit dhe Projekt – Idesë është 14 muaj nga data e lidhjes së kontratës me operatorin.

Neni 5

Detyrimet e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës

1. Mjetet financiare të alokuara nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, me autorizim të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të barten në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, për t'u përdorur si bashkëfinancim në realizimin e këtij projekti.
2. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës do të ketë rol monitorues në përzgjedhjen e operatorit për kryerjen e Studimit të Fizibilitetit dhe Projekt – Idesë.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që lindin mes palëve nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve nëpërmjet konsultimeve.

Neni 7

Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi më datën e pranimit të njoftimi të fundit, me të cilin palët njoftojnë njëra tjetrën përmes kanaleve diplomatike rreth kompletimit të proceduarave të brendshme që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Nënshkruar në Prishtinë, më 20.06.2022 në dy kopje në original, në gjuhën shqipe.

Liburn ALIU



Ministër

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës**

Belinda BALLUKU



Ministër

**Ministria e Infrastrukturës dhe
Energjisë e Republikës së Shqipërisë**